



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Nr: 09/2023

Nr. Protokoli: 15/2023

Date: 22.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës: 21.02.2023, të parashtruar nga Operatoret Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik Lulzim Eq. Gashi B.I.; AR - TECH SH.P.K., P.n. Hajdin Berisha, 23000, Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim-elektrik etj për Administratë ,QKMF dhe shkolla**, me Nr. të Prokurimi: **624-22-3122-1-1-1&624-022-050-111**, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 21.02.2023, e parashtruar nga Operatoret Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik Lulzim Eq. Gashi B.I. AR - TECH SH.P.K., P.n. Hajdin Berisha, 23000, Suharekë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me material hidrosanitari - ndriqim-elektrik etj për Administratë ,QKMF dhe shkolla, me Nr. të Prokurimi: 624-22-3122-1-1-1&624-022-050-111, kundër NJOFTIMI PER DHENJE TE KONTRATES të datës 15.02.2023 të publikuar në platformën elektronike.

- 1. Vërtetohet NJOFTIMI PER DHENJE TE KONTRATES të publikuar me datë: 15.02.2023**
- 2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me dhënie të Kontratës për këtë aktivitetit te prokurimit.**
- 3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë: **21.02.2023**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim-elektrik etj për Administrate ,QKMF dhe shkolla, me Nr. të Prokurimi: 624-22-3122-1-1-1&624-022-050-1111, kundër NJOFTIMI PER DHENJE TE KONTRATES** të datës **15.02.2023** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se kërkesa e juaj është jashtë afatit dhe nuk është parashtruar në mënyrë ligjore ngase është parashtruar kundë njoftimit për Dhenie të Kontratës në të cilën AK është bazuar në vendimin (i cili është obliguar për AK) e OSHP-së nr 671/22 te datës 06.02.2023 Autoriteti Kontraktus vazhdon me procedurën e dhënjes së kontratës .

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

